



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.802/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e Florentina Kukaj kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Glllogoc, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** si i pa rregullt apeli i parashtruar nga Florentina Kukaj kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Glllogoc, me numër ZL.Anr.802/2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

## A r s y e t i m

Me datën 09.11.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Florentina Kukaj, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga subjekti politik PDK, me të cilën thekson se pas publikimit të formularëve nga ana e KQZ-së, kandidatja në fjalë ka numëruar me numër 21, ka numruar 197 vota , ndërsa pas publikimit të rezultateve kanë figuruar vetëm 192 vota.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së ankesës, gjeti se:

### **Apeli është e pa rregullt**

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli e parashtruar nga ana e Florentina Kukaj, nga radhët e PDK-së, me seli në Prishtinë, dega në Glllogoc, është e parregullt, sepse nuk është e nënshkruar nga Florentina Kukaj dhe si e tillë ankesa nuk i plotësojnë kriteret e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6, ku përcaktohet se: Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozitat e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbështetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

ZL. Anr.802/2017 më datën 10.11.2017.



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.